



Pranuar / Dorezuar Prijmjen/Dodato Received/Delivery	29.11.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shënjë Pritog Appendix	Sasia Kolicima Quantity
SKPM SHCK	7491/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOS

A.nr.901/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.901/2022, të datës 13.10.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër vendimit të Kryeinspektorit në Inspektoratin e Punës Nr.1601 të datës 12.09.2022, në çështjen juridike “Kompensim Material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 29.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** pjesërisht si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.901/2022 e datës 13.10.2022 e parashtruar nga ankues.
- II. **OBLIGOHET** Kryeinspektori i TEIP që brenda 15 ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi, ankuesit ti ekzekutoj një pagë jubilarë, sipas dispozitave ligjore që kanë qenë në fuqi në kohën e pensionimit të ankuesit.

A r s y e t i m

Ankuesi i pensionuar sipas vendimit me numër 389 të datës 07.12.2015, fillimisht ka parashtruar ankesë në KPMSHCK me datë 14.01.2016 për pagesën e tri pagave me rastin e pensionimit, KPMSHCK ka nxjerr vendim me Nr. A/02/68/2016 me çka ka detyrua Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të MPMS-së që të trajtoj ankesën e ankuesit dhe të nxjerr aktvendim merititor. MPMS (tani ish MPMS) ka neglizhuar rastin e ankuesit, ankuesi ka ndjek të gjitha shkallët gjyqësore të rregullta të cilat kanë refuzuar padinë e paditësit gjegjësisht ankuesit. Ankuesi ka ngritur çështjen në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykata Kushtetuese ka nxjerr aktgjykim nr.KI51/19 ku ka konstatuar se ankuesit i janë shkelur të drejtat për një gjykim të drejtë dhe efikas. Me qëllim të zbatimit të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetues Kryeinspektori i TEIP ka nxjerr vendim



Nr.1601 të datës 12.09.2022 dhe ankuesit i ka paguar edhe dy paga, ndërsa ka refuzuar pagesën për pagën jubilarë. Ankuesi kundër këtij vendimi ka parashtruar ankesë në KPMSHCK me datë 13.10.2022, me numër protokollit 6139/2022, me pretendime për pagesën edhe të dy pagave me rastin e pensionimit dhe të një page jubilarë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.10.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Inspektorati i Punës, ndërsa Këshilli më datë 11.11.2022, me numër protokollit 7032/2022, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Inspektorati i Punës, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Protokollit 6139/2022 të datës 13.10.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftim për Aktgjykim me Nr. 1242/21/rl i datës 07.06.2021; Aktgjykim në rastin nr.KI51/19 me Nr. ref.RK1802/21 i datës 07.06.2021; Kërkesë për pagesën e tri pagave me rastin e pensionimit dhe pagesën e shpërblimit jubilar me nr. protokollit 24 i datës 14.01.2016; Vendim i Kryeinspektorit në Inspektoratin e Punës me nr. protokollit 1601 i datës 14.09.2022; Fletëtransferi i datës 25.10.2018; Urdhërpaguesë- Dëftesë Pagesë e datës 25.10.2018; Fletëtransferi i datës 13.02.2018; Urdhërpaguesë- Dëftesë Pagesë e datës 13.02.2018; Urdhërpaguesë- Dëftesë Pagesë e datës 16.05.2016; Fletëtransferi i datës 16.05.2016; Fletëtransferi i datës 25.10.2018; Fletëtransferi i datës 13.02.2018; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 27.10.2022; Përgjigje në ankesë e datës 11.11.2022; Dëshmi për pagesë retroaktive e datës 01.12.2015 deri 31.12.2015; Dëshmi për pagesë retroaktive e datës 01.12.2015 deri 31.12.2015; Dëshmi për pagesë retroaktive e datës 01.12.2015 deri 31.12.2015; Pagesa për ditët e punës për Q. L nëntor 2015; Vendim me numër protokollit 389 i datës 07.12.2015; E-mail nga A.B. për C.Z. i datës 16.11.2022; E-mail nga A.H. për A.B. i datës 16.11.2022; E-mail nga A.B. për A.H. i datës 16.11.2022; E-mail nga C.Z. për A.B. i datës 16.11.2022; Akt Emërim i Q.L. me nr. protokollit 49 i datës 07.02.2012; Vendim i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në MPMS-së me nr. protokollit 2379 i datës 05.05.2016; Përshkrimi i Detyrave të Punës për pozitën Inspektor i Punës pa datë; E-mail nga K.S. për C.Z. i datës 23.11.2022; Dëshmi për pagesën e Q.L. e datës 15.11.2022; Vendim i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me nr. protokollit 1410/2016 i datës 12.04.2016;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të gjitha provave të parashtruar nga palët, konstatoi së ankesa e ankuesit është *e bazuar pjesërisht, sepse:*

Kolegji fillimisht ka konstatuar kompetencën lëndore, duke vërejtur se kërkesa e ankuesit hyn në kuadër sa ankuesi ka qenë shërbyes civil, ankuesi nuk është larguar nga shërbimi civil me ndonjë masë apo nuk ka dhënë dorëheqje, por ankuesi është pensionuar sipas ligjit në fuqi, prandaj nga ky fakt është në kompetencën lëndore të KPMSHCK-së shqyrtimi i pretendimeve të ankuesit.

Kolegji pasi ka shqyrtuar pretendimet e ankuesit për pagesën e tri pagave me rastin e pensionimit dhe një page jubilarë sipas Kontratës Kolektive gjegjeshit nenit 52 paragrafi 1.1 ku përcaktohet se I punësuari ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë 1.1 për 10 vjet të përvojës në punë



pandërprerë te punëdhënësi i fundit në vlerë të një page mujore të tij”, ka konstatuar se ankuesit i takon paga jubilarë, ndërsa sipas dëshmisë të përcjellur nga TEIP me vendimin nr. Nr.1601 të datës 12.09.2022 ankuesit i janë realizuar edhe dy paga ndërsa një pagë e kishte marr me rastin e pensionimit.

Kolegji ka marrë për bazë edhe pretendimet e TEIP se lidhur me pagesën e pagës jubilarë për ankuesin është bërë parashkrimi sipas nenit 87 të Ligjit të Punës, por pas analizimit të provave të lëndës, Kolegji konstaton se ankuesi në afat ka bërë kërkesë e parë për pagesën e pagës jubilarë dhe gjithashtu sipas dispozitave ligjore ka ndjek edhe rrugët ligjore, deri sa Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka konstatuar se ankuesit i janë shkelur të drejtat për një gjykim efektiv dhe të drejtë, prandaj si rrjedhojë e tërë kësaj, Kolegji konstaton se Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës është e obliguar ti bëjë një pagesë jubilarë ankuesit sipas dispozitave që kanë rregulluar këtë çështje me rastin e pensionimit të ankuesit.


Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.901/2022

Çlirim ZEKA


Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryeinspektorit në Inspektoratin e Punës;
- Udhëheqësit të Personelit në Inspektoratin e Punës;
- Arkivit të KPMSHCK-së